



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 165

Tiranë – E martë, 15 shtator 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11701, datë 10.9.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11977
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 289, datë 2.9.2020	Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë.....	11977
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 298, datë 10.9.2020	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.....	11979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 21.8.2020	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”.....	11986
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 21.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW.....	11987
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 21.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	11989
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 21.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., nr. 9, seria T15, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 28.7.2015.....	11990
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 21.8.2020	Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘Solaris Power’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”.....	11992
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 21.8.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e kuotave, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, te shoqëria “Free Co” sh.p.k.....	11993

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 28.8.2020	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 22.4.2020, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Green Energy Trading Albania’ sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015”.....	11995
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 28.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Stavec” me kapacitet të instaluar 6000 kW.....	11996
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 144, datë 28.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Mateo & Co” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet të instaluar 2 mW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër.....	11997
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 145, datë 28.8.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror, për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit”.....	11999
	Korrigjim gabimi në ligjin nr. 97/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005, ‘Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit’, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 153, datë 24 gusht 2020.....	12000

**DEKRET****Nr. 11701, datë 10.9.2020****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, germa “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anja Petrit Sulkaj
2. Gerta Isuf Krasa (Kalavace)
3. Altida Ydri Myftarago (Çuka)
4. Leonardi Muamet Myftarago
5. Treisi Adhurim Resuli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 289, datë 2.9.2020****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
PËR PAJISJEN ME PASAPORTË
BIOMETRIKE TË SHTETASVE
SHQIPTARË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008, “Për ratifikimin e ‘Kontratës koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike’, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit SAGEM Security dhe Fondit Shqiptaro-

Amerikan të Ndërmarrjeve”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shtetasi shqiptar (në vijim “shtetasi”) aplikon për t’u pajisur me pasaportë biometrike:

a) brenda vendit, në zyrat e aplikimit të përcaktuara nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) jashtë vendit, në zyrat e përfaqësive diplomatike/konsullore, të përcaktuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2. Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t’u pajisur me pasaportë biometrike, plotëson formularin e identifikimit me fotografi, në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, ku ka vendbanimin.

3. Kur aplikimi për pajisje me pasaportë bëhet jashtë vendit, formulari i identifikimit me fotografi, plotësohet në zyrën konsullore, e cila verifikon të dhënat dhe vijon me procedurat përkatëse.

4. Të dhënat e formularit të identifikimit me fotografi verifikohen nga zyra e gjendjes civile/njësia administrative dhe nga Policia e Shtetit dhe dërgohen në zyrën e aplikimit, brenda:

a) 7 ditëve, për aplikimin e pasaportës me procedurë normale;

b) 1 ditë, për aplikimin e pasaportës me procedurë të përshpejtuar.

5. Për ripajisjen e shtetasit me pasaportë, nuk zbatohet procedura e përcaktuar në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij udhëzimi. Shtetasi aplikon direkt në zyrat e aplikimit, pas rezervimit *online* të takimit në portalin qeveritar *e-Albania*, duke paraqitur kuponin e aplikimit dhe si mjet identifikimi pasaportën ekzistuese.

6. Blerja e kuponit të aplikimit për pasaportë, mundësohet nga çdo vend i autorizuar për shpërndarjen e tij.

7. Shtetasi, nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, aplikon për pasaportë në prani të njërit prind, të kujdestarit ligjor ose të përfaqësuesit me prokurë të posaçme.

8. Shtetasi, deri në moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç, pajisjet me pasaportë pa i marrë shenjat e



gishtave ndërsa mbi këtë moshë është e detyrueshme marrja e tyre.

9. Vlefshmëria e pasaportës për shtetasin nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç është 5 (pesë) vjet.

10. Pajisja me pasaportë biometrike kryhet sipas afateve të mëposhtme:

a) brenda 15 ditëve nga data e aplikimit me procedurë normale, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) brenda 3 ditëve nga data e aplikimit me procedurë të përshpejtuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) brenda 30 ditëve nga data e aplikimit në përfaqësitë diplomatike/konsullore, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

11. Tërheqja e pasaportës kryhet në zyrat e aplikimit nga shtetasi ose i ngarkuari me prokurë të posaçme apo nga kujdestari ligjor për të miturit dhe për shtetasit të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

12. Me kërkesë të personave të autorizuar, pasaporta dërgohet nëpërmjet shërbimit postar, në vendbanimin/adresën e deklaruar prej tyre. Dërgimi i pasaportës me postë ofrohet vetëm nëse të dhënat e vendbanimit/adresës së deklaruar në formularin e identifikimit përputhen me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

13. Punonjësi i shërbimit postar e dorëzon pasaportën vetëm te personat e autorizuar për tërheqjen e saj.

14. Operatori i shërbimit postar është përgjegjës për dëmet e shkaktuara gjatë transportimit të objektit postar, pasaportës. Procedurat dhe mënyra e ofrimit të shërbimit parashikohen në marrëveshjen e përbashkët nëpërmjet autoriteteve kompetente.

15. Shtetasi ripajiset me pasaportë, para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese në rastet e mëposhtme:

a) kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me afatin 6-mujor (gjashtëmujor) të vlefshmërisë së pasaportës. Në këtë rast, pajisja me pasaportë bëhet 6 (gjashtë) muaj përpara;

b) kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile;

c) kur pasaportës i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;

d) kur pasaporta është deklaruar e humbur;

e) kur pasaporta është kallëzuar e vjedhur;

f) kur pasaporta është dëmtuar fizikisht.

16. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, për ripajisjen me pasaportë, subjektet paraqesin për identifikim pasaportën ekzistuese.

17. Në rastin e parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, në momentin e aplikimit për t’u ripajisur me pasaportë pranë zyrave të aplikimit, shtetasi plotëson formularin e vetëdeklarimit të humbjes së pasaportës. Për shtetasit që jetojnë jashtë vendit, vetëdeklarimi kryhet në përfaqësitë diplomatike/konsullore. Në çdo rast shtetasi denoncon humbjen e pasaportës në Policinë e Shtetit.

18. Në rastet e parashikuara në shkronjën “e”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, shtetasi në momentin e aplikimit për t’u ripajisur me pasaportë pranë zyrës së aplikimit apo në përfaqësitë diplomatike/konsullore, paraqet dokumentin përkatës, të lëshuar nga Policia e Shtetit.

19. Në rastin e parashikuar në shkronjën “f”, të pikës 15, të këtij udhëzimi, shtetasi në momentin e aplikimit për t’u ripajisur me pasaportë, duhet të paraqesë pasaportën e dëmtuar. Me pasaportë të dëmtuar kuptohet çdo lloj dëmtimi fizik i këtij dokumenti, që përfshin rastet e mëposhtme:

a) të dhënat janë të padëshifrueshme;

b) është çngjyrosur faqja e të dhënave biometrike;

c) kur ka dëmtime kimike ose me bojë në ndonjë faqe të pasaportës;

d) kur konstatohet mungesa, grisja ose dëmtimi fizik i ndonjë faqeje të pasaportës;

e) kur konstatohet dëmtimi i çipit.

20. Pas prodhimit të pasaportës biometrike, zyra e aplikimit dërgon menjëherë informacion mbi pasaportat e prodhuara në mënyrë shkresore ose elektronike, në strukturën përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përditëson informacionin në sistemet që përdor Policia e Shtetit, duke realizuar njëkohësisht çaktivizimin e pasaportës së vjetër.

21. Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit për prodhimin e pasaportës biometrike, bëhet si më poshtë:

a) formulari i identifikimit me fotografi ruhet në arkiv nga zyra e gjendjes civile në bashki/njësi



administrative dhe nga zyra konsullore, për një periudhë 2 (dy) vjet, pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës;

b) formulari i identifikimit dhe formulari i aplikimit ruhet nga zyra e gjendjes civile në arkiv për një periudhë 5 (pesë) vjet, nga momenti i prodhimit të pasaportës.

22. Në rast të shkeljes së procedurës së parashikuar në këtë udhëzim, kur nuk përbën vepër penale, ndaj punonjësve të ngarkuar me zbatimin e këtij akti, merren masa disiplinore sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës.

23. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ngarkohet për nxjerrjen e formularëve tip të parashikuar në pikat 2 dhe 17, të këtij udhëzimi.

24. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

25. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

26. Udhëzimi nr. 308, datë 8.5.2009, i ministrit të Brendshëm, “Mbi pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

UDHËZIM
Nr. 298, datë 10.9.2020

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË
LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 49, 50 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të dekretit nr. 11700, datë 6.9.2020 të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”,

UDHËZOJ:

1. Brenda datës 21.9.2020, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, të gjenerohet ekstrakti elektronik i përbërësve zgjedhorë, në përbërje të të cilit janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur që nga data 25.4.2003, të cilët deri në datën e zhvillimit të zgjedhjeve, më 25.4.2021, do të mbushin 18 vjeç.

2. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe lista e zgjedhësve gjenerohen në përputhje me procedurën e parashikuar në udhëzimin nr. 225, datë 11.5.2016 të ministrit të Punëve të Brendshme “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin, parashikuar nga ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

3. Grupimin e listës së zgjedhësve, sipas zonave të qendrave të votimit, kufijtë e të cilave janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari i bashkisë, i cili ka marrë njoftimin brenda 48 orëve nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, se ka qendra votimi me më pak se 200 (dyqind) zgjedhës apo qendra votimi me më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, vendos për bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit.

4. Në rastin e institucioneve të posaçme, limiti i poshtëm për qendrën e votimit i referohet një numri prej 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhësish.

5. Për rastet e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari i bashkisë vendos për rindarjen e tyre, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj, do të ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës secila.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 200 (dyqind) zgjedhës, kryetari vendos për bashkimin e kësaj qendre me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor, ku numri i përgjithshëm i zgjedhësve duhet të jetë mbi 200 (dyqind) zgjedhës. Nëse numri i përgjithshëm i zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen



rezulton të jetë më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, atëherë kryetari i bashkisë, pas bashkimit të këtyre qendrave, vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 200 (dyqind) zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël zgjedhësish i bashkohen atyre me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit të bashkisë për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, do t'i dërgohen në formë shkresore për zbatim zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme, si dhe për dijeni Prefektit të Qarkut përkatës, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile.

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile kryen veprimet përkatëse brenda 24 orëve me marrjen e vendimit të kryetarit të bashkisë, për ndarjen e qendrave të votimit.

9. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mosrealizimit të ndryshimeve, nga Regjistri Kombëtar ekzekutohet automatikisht kërkesa për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit të zgjedhësit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë. Në rast se kryetari i bashkisë vendos që adresa e qendrës së votimit të jetë e ndryshme nga adresa e qendrës bazë, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile kryen veprimet për korrigjimin e adresës së qendrës së votimit.

10. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative me marrjen e vendimit të kryetarit të bashkisë për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit, kryen veprimet përkatëse brenda 24 orëve. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mosrealizimit të ndryshimeve, nga Regjistri Kombëtar ekzekutohet automatikisht kërkesa për bashkimin e qendrave të votimit në bazë të vendimit të kryetarit të bashkisë.

11. Procedurat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij udhëzimi do të kryhen për çdo ekstrakt të listës së zgjedhësve.

12. Në rast se kryetari i bashkisë nuk përmbush detyrimet e parashikuara, sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, deri në publikimin e ekstraktit të fundit para publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, të cilat reflektohen në listat përfundimtare të zgjedhësve të datës 25.4.2021.

13. Brenda datës 6.10.2020, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, printojnë ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të të gjithë zgjedhësve, sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial dhe pasi ky ekstrakt firmoset nga kryetari i bashkisë, publikohet në ambientet e bashkive/njësi administrative në vende me hyrje të lirë të aksesueshme për publikun.

Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë me të njëjtat kriterë do të printohen dhe publikohen në mënyrë periodike, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor, jo më vonë se në datat 5.11.2020, 5.12.2020, 4.1.2021, 3.2.2021 dhe 5.3.2021

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile publikon ekstraktet e përbërësve zgjedhorë, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme. Me publikimin e ekstraktit të radhës, ekstrakti i mëparshëm fshihet.

14. Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë, kryetari i bashkisë kryen njoftimin me shkrim të zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e printuar, sipas qendrave të votimit nën juridiksionin e territorit të bashkisë përkatëse.

Njoftimi për shtetasit do të jetë sipas modelit nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, i cili gjenerohet nga sistemi:

a) brenda këtij afati, kryetari i bashkisë njofton për arsyen e mospërfshirjes në listë për shtetasit me moshë mbi 100 vjeç, njoftimi për të cilët do të realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi; si dhe

b) brenda këtij afati, kryetari i bashkisë përmes drejtuesit të institucioneve të posaçme, njofton shtetasit që kanë mbushur moshën e së drejtës së votimit, por që këtë të drejtë e kanë humbur si pasojë e të qenit subjekt i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar.



Njoftimi për këta shtetas do të realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

15. Zgjedhësit, të cilët kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka pasaktësi, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme.

16. Të drejtën për kërkesë për korrigjimin e qendrës së votimit e kanë dhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç. Këta shtetas do të bëjnë kërkesë për ndryshimin e qendrës së votimit nga 8899 (numërtim i vendosur nga sistemi vetëm për këtë grup zgjedhësish), në qendrën e votimit sipas vendbanimit të tyre. Kjo kërkesë realizohet sipas modelit nr. 4, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

17. Krahas ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative do të pasqyrojë edhe rastet e vendimeve të gjykatave, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve.

18. Më datë 16.3.2021, çdo zyrë e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, printon listën e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar dhe

firmos për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzon kryetarit të bashkisë.

19. Brenda datës 21.3.2021, kryetari i bashkisë miraton dhe firmos listën dhe e dërgon në të tria formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në KZAZ-të përkatëse.

20. Jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave një kopje të listës në format elektronik.

21. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi kryetarët e bashkive, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj



Modeli 1

NJOFTIMI I ZGJEDHËSVE

Qarku: _____

Bashkia: _____ / Njësia Administrative _____

Numri banesës: _____

Të nderuar,

Z./Znj. <Emri> < emri i babait> <mbiemri>, datëlindja <__ / __ / __>, Numri rendor në listë: <nr>

Z./Znj. <Emri> < emri i babait> <mbiemri>, datëlindja <__ / __ / __>, Numri rendor në listë: <nr>

Z./Znj. <Emri> < emri i babait> <mbiemri>, datëlindja <__ / __ / __>, Numri rendor në listë: <nr>

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, që do të zhvillohen më datë 25.04.2021, jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër <Nr QV>, me adresë: <Adresa QV>

KRYETARI I BASHKISË

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë: __ / __ / ____



Modeli 2

NJOFTIMI I ZGJEDHËSVE ME MOSHË MBI 100 VJEC NË DATËN E VOTIMIT

Qarku: _____

Bashkia: _____

Numri banesës: _____

I/e nderuar/a Z./Znj. _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që do të zhvillohen më datë 25.04.2021, në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si shtetas që keni mbushur moshën 100 vjeç, nuk jeni të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhore të qendrës së votimit.

Sipas nenit 53 të Kodit Zgjedhor, përt’u përfshirë në listën e zgjedhësve, duhet t’i drejtoheni me kërkesë zyrës së gjendjes civile ku jeni i regjistruar.

KRYETARI I BASHKISË

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë: __/__/____



Modeli 3

***NJOFTIM I KRYETARIT TË BASHKISË PËR ZGJEDHËSIT, TË CILËVE U HIQET E DREJTA E VOTIMIT PËR SHKAK TË QËNIES SUBJEKT I LIGJIT NR.138/2015
“PËR GARANTIMIN E INTERGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN ,
EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”***

Bashkia: _____,

Emërtimi i Institucionit: _____

I/enderuar/a Z/Znj. _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që do të zhvillohen më datë 25.04.2021, në mbështetje të gërmaxhve “a” dhe “b”, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në cilësinë e subjektit të këtij ligji, nuk rezultoni i përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrës së votimit.

KRYETARI I BASHKISË

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë: __/__/____



MODELI 4

*KËRKESA E ZGJEDHËSIT ME MOSHË MBI 100 VJEC NË DATËN E VOTIMIT PËR
T'U PËRFSHIRË NË LISTËN E ZGJEDHËSVE*

K Ë R K E S Ë

Bashkisë _____ / Njësisë Administrative _____

Zyrës së Gjendjes Civile: _____

Unë i nënshkruari _____ banor në Bashkinë _____ /
Njësi Administrative _____, pasi mora njoftimin e kryetarit të bashkisë, se nuk jam
i përfshirë në listën e zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që do të zhvillohen më
datë 25.04.2021, paraqes këtë kërkesë, për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve të qendrës së
votimit Nr. _____, ku rezultojnë të regjistruar dhe anëtarët e tjerë të familjes / ku kam
vendbanimin.

(Emër, Mbiemër)

(nënshkrimi)

Datë: ____ / ____ / ____



VENDIM
Nr. 136, datë 21.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLORES PËR PROCEDURAT E
SHITJES SË TEPRICAVE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN
E PARREGULLUAR, PËR SHOQËRINË
PUBLIKE TË FURNIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 11, pikat 2 dhe 3, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 96/7 prot., datë 17.8.2020, e përgatitur nga Drejtoria Teknike, mbi miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”,

konstatoi se:

- Shoqëria FTL sh.a., me shkresën e saj nr. 633/5 prot., datë 22.7.2020, ka sjellë për miratim në ERE draftin e rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Kërkesa e mësipërme vjen si rezultat i ndryshimeve në VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, me VKM-në nr. 883, datë 27.12.2019, ku neni 11, pika 3, përcakton se: Në rast të tepricave të krijuara ato do të tregtohen në treg të parregulluar me çmimin që ofron ky treg në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë.

- Shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë” (FTL sh.a.), është krijuar në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar,

të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe të Urdhrit të Asamblesë së përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike “OSHEE” sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues dhe shoqërisë mëmë.

- Kjo shoqëri është licencuar nga ERE në aktivitetin e tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, respektivisht me vendimet nr. 198, datë 3.9.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. (FTL sh.a.)’ në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe nr. 199, datë 3.9.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Furnizuesi i tregut të lirë (FTL sh.a.)’ në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 10.2.2020, mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë FTL sh.a., më herët vendosi:

- Për një periudhë tranzitore deri në miratimin e rregullave të tregtimit të energjisë elektrike, Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.), për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata elektroenergetike shqiptare (KESH sh.a.)” të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.6.2019, të asamblesë së përgjithshme të aksionarit.

- Furnizuesi i tregut të lirë (FTL sh.a.) të propozojë për miratim në ERE, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregullat për tregtimin e energjisë elektrike të mbështetur në parimet e barazisë dhe të transparencës.

- Vendimmarrja e mësipërme erdhi në kushtet kur mungonte një platformë shitje për energjinë elektrike nga ana e FTL sh.a., dhe duhej kohë për krijimin e saj, ndërkohë që procesi ishte në emergjencë, pasi FTL sh.a. mund të ishte përpara një situatë me reshje dhe historiku ka treguar se prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike gjatë muajve shkurt-prill arrijnë prodhimin e tyre maksimal, çka mund të gjeneronte nevojën për zhvillimin e procedurave të tregtimit të tepricave të energjisë elektrike nga kjo kategori.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 66, datë 8.4.2020, për një ndryshim në vendimin



e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 10.2.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë, FTL sh.a.”, vendosi:

- Në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 24, datë 10.2.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë, FTL sh.a.” bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) FTL sh.a. të propozojë për miratim në ERE, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të fuqisë juridike të akteve ligjore të Qeverisë Shqiptare për mbrojtjen nga epidemia Covid-19, rregulloren e tregtimit të energjisë elektrike, të mbështetur në parimet e barazisë dhe të transparencës.

- Rezulton se kërkesa e FTL sh.a. për miratimin e rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar, është paraqitur brenda afateve të parashikuara në vendimmarrjet e mësipërme të Bordit të ERE-s.

- Qëllimi i rregullores është të përcaktojë procedura eficiente dhe praktike nëpërmjet të cilave, të nxisë pjesëmarrjen e tregtarëve në procesin e shitjes së energjisë elektrike, në mënyrë që të nxisë konkurrencën dhe të mundësojë shitjen e energjisë elektrike me çmime sa më të larta, duke siguruar transparencë, si dhe mundësi të barabarta për të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në procedurat e shitjes së energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Draft-rregullorja e propozuar nga FTL sh.a. për miratim, është një dokument i cili trajton përgjithësisht procesin e tregtimit të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe do t'i nënshtrohet konsultimeve me palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 137, datë 21.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MALI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1490 kW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 96/1 prot., datë 21.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 997 prot., datë 22.7.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.



- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., (mbajtësi i miratimit), është regjistruar pranë QKB-së në datën 7.8.2017, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të Biznesit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. ka: financimin, ndërtimin e hidrocentraleve, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve, bazuar në ligjet e Shtetit Shqiptar.

- Kontrata nr. 99 rep., nr. 75 kol., datë 16.1.2019, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Mali’ me kapacitet prodhues 1.490 mW, në rrjedhën e ujit të pa trajtuar të ujësjellësit Bovillë, lumi Tërkuzë, Bashkia Tiranë, qarku Tiranë, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi me nënshkrimin e palëve dhe me të drejtë rinovimi.

- Referuar oponencës teknike, dërguar në MIE me shkresën nr. 6815/7 prot., datë 10.10.2018, të kryer për projektin e zbatimit të HEC “Mali”, për të cilin edhe dhënë nga MIE miratimi përfundimtar nr. 192/2, datë 10.1.2019, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë HEC ‘Mali’, në rrjedhën e ujit të patrajtuar të tubacioneve të ujësjellësit Bovillë, lumi Tërkuzë, Bashkia Tiranë, qarku Tiranë”, rezulton se vlerat e parametrave të HEC-it “Mali” që pasqyrohen në projektin e zbatimit, janë të njëjtat me ato të pasqyruara në raportin e oponencës teknike dhe rrjedhimisht edhe në kontratën e nënshkruar mes MIE-s dhe mbajtësit të miratimit “Tirana Energji” sh.p.k.,

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., ka përcjellë në ERE marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes me nr. 17056/2 prot., datë 3.01.2019, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OSHEE sh.a.,

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit uhor” me nr. 2369/4, datë 24.9.2019, të miratuar nga KBU Ishëm–Erzen me vendimin nr. 13, datë 20.9.2019 (depozituar në ERE), për shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., me qëllim përdorimin e ujit për prodhim energjie nga HEC “Mali”, me kapacitet 1.49 mW.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, VNM-n paraprake lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 2626 prot., datë 12.9.2018 dhe nr. 679 identifikimi dhe nr. 42 vendimi, për personin juridik “Tirana Energji” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtim i HEC ‘Mali’, me kapacitet 1490 kW.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

- Neni 9, pika 2, germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së dhe ekstraktin e përditësuar.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të paraqesë vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k. dhe përfaqësuesin ligjor të saj (neni 7, pika 4, germa “b”).

- germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE licencën për drejtuesit teknik elektrik.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës që konsiston në vërtetimin e aftësisë ose mbështetjes financiare të aplikuesit.

- Dokumentacioni teknik për HEC

- Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat mbi skemën e lidhjes së përcjellësve siç kërkuar në formatin e kësaj pike të rregullores.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e



energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Sikurse cituar edhe më sipër, kontrata me MIE-n nr. 99 rep., nr. 75 kol., datë 16.1.2019, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Mali’ me kapacitet prodhues 1.490 mW, në rrjedhën e ujit të patrajtuar të ujësjellësit Bovillë, lumi Tërkuzë, Bashkia Tiranë, qarku Tiranë, ka një afat prej 49 vjet. ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 138, datë 21.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 96/2 prot., datë 13.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 997 prot., datë 22.7.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.



- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8; germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 7.8.2017, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. ka: financimin, ndërtimin e hidrocentraleve, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve, bazuar në ligjet e shtetit shqiptar.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra kombëtare e biznesit, (QKB)). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të QKB-së, datë 14.1.2020, nga përmbajtja e të cilit rezulton se shoqëria është regjistruar në datën 7.8.2017. Do t’i kërkohej shoqërisë të përcjellë certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së dhe ekstraktin të përditësuar në data.

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të paraqesë vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k. dhe përfaqësuesin ligjor të saj (neni 7, pika 4, germa “b”).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal.

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Pa plotësuar. Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin përkatës.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8,

- germa “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve.

- germa “b”. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtorja Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 139, datë 21.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “YLLIAD” SHPK, NR. 9,
SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 97,
DATË 28.7.2015**

Në mbështetje të nenit 16, neni 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; neni 5, pika 1, germa “e”; neni 8, neni 9, neni 10, pikat 1 dhe 3, si dhe neni 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109,



datë 29.6.2016, të ndryshuar, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 96/5 prot., datë 17.8.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. ref. YTL 04-2020, datë 29.7.2020, protokolluar në ERE me nr. 1013/1 prot., datë 29.7.2020, shoqëria “YLLIAD” sh.p.k. ka depozituar në ERE aplikimin për rinovimin e licencës nr. 9, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 28.7.2015.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 28.7.2015, ka vendosur:

“Të rinovojë licencën e shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 22.12.2010, për një afat 5-vjeçar.

- Në zbatim edhe të pikës 1, germa “a”, të vendimit të Bordit nr. 133/2020, ku është vendosur të shtyhet deri më 1. 9.2020, afati i dorëzimit të aplikimit për rinovim licence të të gjitha subjekteve, afati për aplikim për rinovim licence i të cilave përfundon, apo ka përfunduar deri në 30 qershor 2020, shoqëria legjitimohet në kërkesën për rinovimin e licencës duke e vlerësuar atë të kryer brenda parashikimeve ligjore të miratuara nga ERE.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”,

“d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar pjesërisht.

Mungon germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Shoqëria ka depozituar shkresën e OTP BANK, ku përcaktohet volumi në euro i shoqërisë në këtë bankë. Po ashtu shoqëria ka deklaruar kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të energjisë, i cili rezulton më i lartë se gjendja bankare e shoqërisë. Sa më sipër, edhe pse rezulton që bilancet e saj janë mbyllur me fitim, do t'i kërkohej shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me mënyrën se si parashikon të garantojë këtë diferencë në shumën e parashikuar.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar pjesërisht.

Mungon germa “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.). Duke qenë se shoqëria ka deklaruar kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është më i lartë se shuma që rezulton nga gjendja bankare e shoqërisë, edhe pse referuar pasqyrave financiare të shoqërisë, rezulton që bilancet e saj janë mbyllur me fitim, do t'i kërkohej shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me mënyrën se si parashikon të garantojë këtë diferencë në shumën e parashikuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 9, seria T15, të shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 28.7.2015, për një afat 5-vjeçar.



2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 140, datë 21.8.2020

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 86, DATË 12.5.2020, “MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË ‘SOLARIS POWER’ SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, dhe nenit 5, pika 1, germa “e”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s 109/2016, të ndryshuar; nenit 16, pika 2, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 96/8 prot., datë 17.8.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 12.5.2020, vendosi të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak se shoqëria nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk e ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.

Faqe | 11992

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447/2 prot., datë 28.5.2020, shoqëria “Solaris Power”, ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 86/2020.

- Bashkëlidhur kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 86/2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. ka depozituar dhe një pjesë të dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Me shkresën nr. 447/4 prot., datë 19.6.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. ka kërkuar zgjatjen e afatit me 10 ditë të tjera për depozitimin e këtij dokumentacioni.

- Me vendimin nr. 110, datë 2.7.2020, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e shqyrtimit të kërkesës të shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës të shoqërisë ‘Solaris Power’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”. Shoqëria u njoftua për këtë vendim marrje të Bordit, me shkresën e ERE-s nr. 447/5 prot., datë 17.7.2020.

- Me shkresën e datës 10.8.2020, protokolluar në ERE, me nr. 447/6 prot., datë 17.8.2020, shoqëria është shprehur se pamundësia dhe vështirësia e pajisjes me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e ERE-s ka ardhur si pasojë e situatës së krijuar, për shkak të pandemisë COVID-19.

- Dokumentacioni i nevojshëm për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike kryesisht i plotësuar nga ana e shoqërisë.

Dokumentacioni që rezulton i plotësuar pjesërisht apo i paplotësuar është si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikimin): plotësuar pjesërisht;

- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit): plotësuar pjesërisht;

- germa “c” (të dhëna për aplikuesin): plotësuar pjesërisht.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike:

Neni 9, pika 4.8:

- germa “a” (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në Gwh sipas viteve): pa plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.5.2020, ndryshon dhe bëhet:

1. Të licencojë shoqërinë “Solaris Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kusht që:

a) Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar, si më poshtë:

i. formatin me të dhënat për aplikim, sipas kërkesave të germave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 9, pika 1, të rregullores, të plotësuar sipas formatit të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109/2016, të ndryshuar;

ii. informacionin përkatës në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në Gwh sipas viteve.

b) Shoqëria të mos fillojë ushtrimin e veprimtarisë së licencuar pa plotësuar dokumentacionin e munguar.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

2. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria nuk plotëson dokumentacionin e munguar në afatin e përcaktuar.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 141, datë 21.8.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE, QË PËRBËJNË 100% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË, TE SHOQËRIA “FREE CO” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 5.2, të “Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, pikës 6.2, të “Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 96/4 prot., datë 17.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., në lidhje me transferimin e 100% të kuotave të shoqëria “Free CO” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 289, seria PV15K, për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit nr. 70, datë 13.5.2015, si dhe licencës nr. 302, seria T15P, për tregtimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit nr. 96, datë 28.7.2015.

- Me shkresën nr. 17 prot., datë 18.6.2020, protokolluar në ERE me nr. 787, datë 18.6.2020, shoqëria ka informuar ERE-n në lidhje me transferimin të shoqëria “Free CO” sh.p.k. të pjesëve të kapitalit që shoqëritë “Bio Energy 15” sh.p.k. dhe “Alsi & Co” sh.p.k. kanë të shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k.

- Ky transferim është miratuar nga MIE me shkresën nr. 8345 prot., datë 8.11.2019, dhe shoqëria është në pritje të kontratës shtesë të koncesionit në lidhje me këtë transferim.

- Me shkresën nr. 17 prot., datë 18.6.2020, ka informuar ERE-n në lidhje me ndryshimin e



administratorëve dhe të adresës së selisë qendrore të shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k.

- Nga të dhënat e verifikuara nga ekstrakti historik i shoqërisë rezulton se shoqëria nuk ka njoftuar brenda 10 ditëve, sipas afatit të përcaktuar në kushtet e licencave që disponon, për ndryshimin e administratorëve dhe të adresës së zyrës qendrore të shoqërisë, ndaj me shkresën nr. 787/1 prot., datë 17.7.2020, ERE ka kërkuar nga shoqëria informacion në lidhje me shkaqet që e kanë penguar në përmbushjen e detyrimeve në kohë.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën nr. 22 prot., datë 24.7.2020, protokolluar në ERE me nr. 787/2 prot., datë 24.7.2020, duke sqaruar se mosnjoftimi i ERE-s në kohë për ndryshimin e adresës, administratorit dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë, ka ardhur si pasojë e situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga COVID-19, çka ka shkaktuar pengesa në komunikimet me institucionet kompetente, duke marrë parasysh dhe faktin se ortakut i ri i shoqërisë, shoqëria “Free CO” sh.p.k. zotërohet nga shoqëritë italiane “LO Srl” dhe “PAFA Srl”, dhe Italia ishte prekur disa muaj më parë se vendi ynë nga kjo gjendje.

- Në lidhje me procedurën e ndjekur për ndryshimin e ortakut të shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., shoqëria ka sqaruar se janë zbatuar të gjitha procedurat për marrjen e miratimit për transferimin e pronësisë së pjesëve të kapitalit nga autoriteti kontraktues MIE, dhe se procesi i transferimit të kuotave nuk ka përfunduar për shkak të moslidhjes së kontratës së koncesionit për bartjen e të drejtave dhe detyrimeve, si dhe ka deklaruar se do të paraqesë në ERE, pa vonesë, dokumentacionin përkatës për marrjen e këtij miratimi.

- Me shkresën nr. 23 prot., datë 3.8.2020, protokolluar në ERE me nr. 787/3 prot., datë 5.8.2020, në zbatim të pikës 6.2, të “Licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike” dhe pikës 5.2, të “Licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, shoqëria ka paraqitur kërkesën e saj për marrjen e miratimit të ERE-s për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k.

- Duke marrë parasysh rrethanat e krijuara për shkak të COVID-19, e po ashtu kufizimet e

vendosura me qëllim minimizimin e rrezikut të përhapjes së këtij infeksioni, vlerësojmë të justifikuar vonesën në njoftimin e ERE-s për ndryshimet e ndodhura.

- Shoqëria ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e miratimit nga ana e ERE-s, për transferimin e kuotave që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për transferimin e kuotave, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., të shoqëria “FREE CO” sh.p.k.

2. Shoqëria “Kisi-Bio-Energji” të depozitojë në ERE kontratën shtesë të koncesionit që reflekton këtë transferim.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 142, datë 28.8.2020

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 72, DATË
22.4.2020, “MBI RINOVIMIN E
LICENCËS SË SHOQËRISË ‘GREEN
ENERGY TRADING ALBANIA’ SHPK,
NR. 286, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 59,
DATË 23.4.2015”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/1 prot., datë 19.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., mbi plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 72, datë 22.4.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 72, datë 22.4.2020, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015”, vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nr. 286, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 59, datë 23.4.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.4.2020.

2. Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. të depozitojë në ERE jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë COVID-19, vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, germa “d” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,

miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Me shkresën nr. 657 prot., datë 22.4.2020, u njoftua shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në lidhje me vendimarrjen e ERE-s për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, nr. 657/1 prot., datë 16.7.2020, u njoftua shoqëria në lidhje me detyrimin për të depozituar në ERE, jo më vonë se një muaj nga përfundimi i pandemisë COVID-19, dokumentacionin e munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 657/2, datë 22.7.2020, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimet nga Gjykata dhe Prokuroria, nga të cilat rezulton se ndaj administratorit të shoqërisë nuk rezulton të ketë procedim penal apo proces gjyqësor të regjistruar në ngarkim të tij.

- Shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe të Prokurorisë për përfaqësuesin ligjor të saj, nga të cilat rezulton se nuk ka procedim penal apo proces gjyqësor të regjistruar në ngarkim të tij.

- Rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 22.4.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 2, të vendimit nr. 72, datë 22.4.2020, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të licencuarin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 143, datë 28.8.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOKA &
ERGI ENERGY STAVEC” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC
“STAVEC” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 6000 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/2 prot., datë 21.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 976 prot., datë 16.7.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., është shoqëri koncesionare e themeluar si detyrim i kontratës së koncesionit nr. 809 rep., nr. 140 kol., datë 17.4.2008 dhe është regjistruar pranë QKB-së në datën 27.6.2008, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Kontrata nr. 809 rep., nr. 140 kol., datë 17.4.2008, “Kontratë koncesioni e formës BOT (Ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentralit Stavec”, e lidhur midis METE-s

(sot MIE) dhe koncesionarit “Koka” sh.p.k., ka një afat 35-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Referuar kontratës nr. 809 rep., nr. 140 kol., datë 17.4.2008, HEC “Stavec” ka një kapacitet prej 6000 kW dhe prodhim energjie rreth 25 620 000 kWh.

- Aplikuesi ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, apo dokumentacionit të paraqitur jo në formën e parashikuar nga rregullorja, që ka të bëjë me:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1, germa “c” (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 2, germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë, vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Plotësuar pjesërisht.

- Neni 9, pika 2, germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik. Plotësuar pjesërisht.

- Neni 9, pika 2, germa “f” (Marrëveshje koncesioni apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme, të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, si dhe ndryshim të këtyre akteve). Plotësuar. Aplikuesi duhet të japë shpjegime në lidhje me afatet e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit, si dhe statusin e kësaj kontrate apo kontratave shtesë.

- Neni 9, pika 4.1.4, germa “c”. Oponenca teknike e projektit – Plotësuar pjesërisht. Në vijim do t’i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe oponencën teknike të hartuar përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit.



- Neni 9, pika 4.1.5, germa “b”. Leja e përdorimit të ujit – Pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor”.

- germa “c”. Leja Mjedisore – Plotësuar. Aplikuesit do t’i kërkohet të japë shpjegime dhe/ose dokumentojë statusin e lejes mjedisore që disponon.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të paraqesë dokumentacionin e munguar, atë shtese apo shpjegues.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Stavec”, me kapacitet të instaluar 6000 kW, për një afat 23-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 144, datë 28.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MATEO & CO” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MURASI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I BASHKUAR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/3 prot., datë 25.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 prot., datë 14.8.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë QKB-së në datën 20.5.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Në objekt të veprimtarisë së saj, shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. ka prodhimin e energjisë elektrike.

- Në vijim të depozitimit të kërkesës për aplikim, shoqëria ka dërguar në ERE shkresën e



protokolluar me nr. 1053/1 prot., datë 20.8.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar dokumentacion për qëllime të këtij aplikimi.

- Kontrata nr. 1768 rep., nr. 784/3 kol., datë 26.7.2017, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Murasi” me kapacitet prodhues 2 mw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, aplikuesit “MATEO & CO” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë ripërsëritjeje.

- MIE ka dhënë për këtë projekt, miratimin përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.7.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, qarku Shkodër”.

- Shoqëria ka paraqitur urdhrin e ministrit të Mjedisit nr. 116, datë 14.4.2017, “Për vijimin e procedurave për heqje nga fondi pyjor kullësor publik të një sipërfaqeje prej 0.1398 ha në funksion të ndërtimit të HEC ‘Murasi 1 dhe 2’, në kaskadën e lumit ‘Cemi i Selcës’, nga shoqëria ‘MATEO & CO’ sh.p.k., në Bashkinë Malësi e Madhe”.

- Shoqëria ka depozituar kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor publik”, me nr. 2299 prot., datë 1.6.2017, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit. Afati i kësaj kontrate ka qenë 1-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj (1.6.2017).

- Aplikuesi ka depozituar dhe kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor publik”, me nr. 6418 prot., datë 8.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, me afat 5-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.

- Shoqëria ka depozituar dhe vërtetimet në dokument hipotekar të lëshuar nga ZVRPP Malësi e Madhe, datë 29.5.2017, që korrespondojnë me zonën ku do të shtrihet projekti.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE sh.a. 27446/2 prot., datë 21.11.2016, “Miratim pikë

lidhje”, drejtuar shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., ku përcaktohet se HEC-i, do të lidhet me rrjetin shpërndarës në linjës 35 kV, të n/stacionit Tamarë.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot., datë 20.4.2017, të miratuar nga KBU Drin-Bunë, me vendimin nr. 11, datë 10.4.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e HEC “Murasi”, duke përdorur burimin ujor Lumin Cemi i Selcës, degë e Lumit Cemi i Bashkuar. Në këtë leje citohet se periudha e vlefshmërisë së saj është deri më 9.4.2022. Në këtë leje rekomandohet të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike. Aplikuesi duhet të japë shpjegim në lidhje me kohëzgjatjen e vlefshmërisë së kësaj leje.

- Shoqëria ka paraqitur VNM-në paraprake lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 2829 prot., datë 2.12.2016 dhe nr. 712 identifikimi dhe nr. 59 vendimi, për personin juridik “MATEO & CO” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ‘Ndërtim-operim i HEC ‘Murasi’, me kapacitet 2000 kw.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit apo dokumentacionit të paraqitur jo në formën e parashikuar nga rregullorja, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

Mungon dokumentacioni që lidhet me parashikimet e nenit 9, pika 2, germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata): plotësuar pjesërisht. Nga ekstrakti historik i QKB-së i shoqërisë rezulton se selia e shoqërisë është në Shkodër, në vijim do t’i kërkohet që të sjellë vërtetimet e gjendjes gjyqësore të drejtuesve të shoqërisë dhe për këtë qark.

- Neni 9, pika 4.1.4, “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”, germa “c”, oponenca teknike e projektit: plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar në ERE në formatin fotokopje, raportin e oponencës teknike të AKBN-së nr. 2572 prot., datë 20.3.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC-it “Muras” miratuar nga MEI me miratimin përfundimtar nr. 3719/13, datë



13.7.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, qarku Shkodër. Do t’i kërkohet shoqërisë që ta depozitojë atë të noterizuar/njësuar me origjinalin.

Për gjithë sa më sipër do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2 mw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 145, datë 28.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS TIP TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR, PËR KLIENTËT FUNDORË QË PËRFITOJNË NGJA SHËRBIMI PUBLIK I FURNIZIMIT”

Në mbështetje të nenit 16 dhe neneve 75, 89, 92, 93 dhe 94, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe nenit 26, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe

procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/4 prot., datë 26.8.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit që parashikon kushtet e përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit,

konstatoi:

- Në përmbushje të detyrimeve që cakton ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, parashikuar në nenin 16, pika 10, neneve 92, 93, pika 1, ERE miraton kushtet e përgjithshme të furnizimit për klientët fundorë, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të licencuarit, në aktivitetin e furnizimit publik në sektorin e gazit natyror.

- Dispozitat e kontratës së furnizimit me gaz natyror duhet të jenë të drejta, proporcionale, të qarta dhe të kuptueshme, dhe duhet të aplikohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

- Në këtë rregullore përcaktohet se kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të kenë pengesa në ushtrimin e të drejtave të klientit fundorë dhe nuk duhet të paraqesin metoda të padrejta ose çorientuese të shitjes, matjes, faturimit dhe/ose pagesës.

- Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të përmbajnë dispozita që mund të parandalojnë ose pengojnë klientin nga ndërprerja e njëanshme e kontratës, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këto rregulla dhe/ose ndryshimi pa pagesë i furnizuesit, sipas rregullave të ndryshimit të furnizuesit, të miratuara nga ERE.

- Drafti me kushtet e përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientin fundor që përfiton nga shërbimi publik i furnizimit, është hartuar në mbështetje të neneve 75, 89, 92, 93, 94, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, gjithashtu dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.



- Drafti i kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, do të konsultohet me palët e interesit, përpara miratimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror, për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KORRIGJIM GABIMI

Në ligjin nr. 97/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005, ‘Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit’, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 153, datë 24 gusht 2020, faqe 9697, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 1, e nenit 6 ishte:

Në fund të pikës , shtohet fjalia “Vlerësimi i punës bëhet edhe me kërkesën e punonjësit.”.

bëhet:

Në fund të pikës 1 shtohet fjalia “Vlerësimi i punës bëhet edhe me kërkesën e punonjësit.”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë